

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"SCANDIC INVEST" SH.P.K.

Kavaje, me 25.11.2024

Ortakët themelues:

- **Afrim Alija** banues në Kosovë me nr. personal 1006417058.
- **Jonas Leif Olsson** banues në Suedi me nr. personal 890204-4877.
- **Bekim Beck** banues në Suedi me nr. personal 780412-5271.
- **Lim Aliu** banues në Suedi me nr. personal 931104-3914.

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar), sot më datë 25.11.2024 harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare si më poshtë vijon:

NENI 1

Emri

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin "SCANDIC INVEST" SH.P.K.

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

NENI 2

Forma

2.1 Shoqëria tregtare "SCANDIC INVEST" SH.P.K. ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "SCANDIC INVEST" SH.P.K. do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën: Kavaje, Qerret, Rruga Pavaresia e Kosoves, banesa nr. 139, zona kadastrale 3101.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë



4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare si agjensi imobiliare në shit-
blerjen e pasurive të paluajtshme.

NENI 5

Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë "SCANDIC INVEST" SH.P.K. do të jetë me
afat të pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

6.1 Shoqëria tregtare "SCANDIC INVEST" SH.P.K. mund të hapë degë të saj ose
zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

7.1 Ortakët nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë "SCANDIC INVEST" SH.P.K.
dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të
kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8


Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "SCANDIC INVEST"
SH.P.K. është 100.000 (njëqindmije) lekë.

8.2 Ortakët e shoqërisë janë:

- 1- Z. Afrim Alija është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 10% të kapitalit të
shoqërisë ose në vlerë 10.000 lekë.
- 2- Z. Jonas Leif Olsson është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 22,5% të
kapitalit të shoqërisë ose në vlerë 22.500 lekë.
- 3- Z. Bekim Beck është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 22,5% të kapitalit të
shoqërisë ose në vlerë 22.500 lekë.
- 4- Z. Lim Aliu është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 45% të kapitalit të
shoqërisë ose në vlerë 45.000 lekë.

NENI 9



Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10

Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Ortakë e Shoqërisë. Afati i emërimit është 5 (Pese) vjet. Kompetencat e adminsitраторit përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është **Z. Afrim Alija** atësia Sheremet, lindur ne Likoc, Kosove dhe banues ne Prishtine, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar me numër personal 1006417058.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore.

ORTAKËT E SHOQERISE

"SCANDIC INVEST" SH.P.K.


Afrim Alija



Jonas Leif Olsson



Bekim Beck



Lim Aliu

